

FEDERATA E KARATESË E KOSOVËS  
KOSOVA KARATE FEDERATION



RREGULLORE  
PËR MËDITJE, PAGESA DHE SHPËRBLIME

Prishtinë, 2021

*Rregullore për meditje, pagesa dhe shpërblime*

# RREGULLORE PËR MËDITJE, PAGESA DHE SHPËRBLIME

## I. Dispozitat e Përgjithshme

### Neni 1

Me këtë Rregullore, përcaktohen udhëtimet, procedura e pagesës së kompensimit për udhëtime brenda dhe jashtë vendit, mëditjet për këto udhëtime, paradhënia dhe shpenzimet për udhëtime për personat që kryejnë punë dhe detyra për nevojat e FKK-së.

### Neni 2

#### PROCEDURA PËR REALIZIMIN E UDHËTIMEVE

##### Perfituesit sipas kësaj rregullorje

1. Delergacioni i Kosovës pjesëmarrës në Kampionate Botërore, Evropiane, Mediterane dhe garat tjera të miratuara nga Bordi Ekzekutiv i FKK-së, si dhe udhëtime zyrtare të miratuara nga i njëjti Bord duke respektuar procedurat e nenit 3, kategorit përfituese janë si me poshtë:
  - Kryetar i FKK-së;
  - Sekretari i Përgjithshëm i FKK-së;
  - Nenkryetaret e FKK-së;
  - Anëtarët e Bordit Ekzekutiv të FKK-së;
  - Selektori/et e FKK-së;
  - Trajneri/et e FKK-së;
  - Gjyqëtarët e FKK-së; dhe
  - Çdo anëtarë i FKK-së i cili dërgohet me autorizim të Bordit Ekzekutiv të FKK-së.
2. *Garuesit* të cilët përfaqësojnë Kosovën në kampionate Botërore, Evropiane, Mediterane si dhe në Premier Liga dhe Serie A në kategorinë e Seniorëve, ku Federata e Karatesë është organizatore e udhëtimit.
3. *Garuesit* të cilët përfaqësojnë Kosovën në kampionate Botërore, Evropiane, Mediterane në kategoritë Kadetë, Juniorë dhe U21, ku Federata e Karatesë është organizatore e udhëtimit.

### Neni 3

1. Kërkesa për udhëtime duhet të dorëzohet më së paku pesë (5) ditë pune para shkuarjes në udhëtim, përveç rasteve të jashtëzakonshme.
2. Për çdo kërkesë për udhëtim duhet plotësojë këto kushte:

- a) Ngjarja për të cilën aplikohet duhet të jetë e aprovuar nga Bordi Ekzekutiv i FKK-së.
- b) Janë të obliguar që të plotësojnë Formularin e kërkesës për udhëtime,
- c) Pas verifikimit të Formularit të kërkesës për udhëtim, kërkesa do t'i dorëzohet Sekretarit të Përgjithshëm.
- d) Nëse Sekretari i Përgjithshëm vlerëson se personi i cili ka parashtruar kërkesën për udhëtim nuk ka dhënë arsyetimin e duhur, Sekretari nuk do të aprovojë udhëtimin apo do ta kthejë në rishikim dhe plotësim kërkesën në Bordin Ekzekutiv.

#### **Neni 4**

Në Formularin e udhëtimit përfshihen këto të dhëna:

1. Emri dhe Mbiemri i personit që udhëton;
2. Punët dhe detyrat që duhet kryer;
3. Vendi dhe shteti ku duhet udhëtuar;
4. Koha e nisjes dhe kohëzgjatja e udhëtimit;
5. Forma e udhëtimit e cila do të shfrytëzohet;
6. Avansi financiar: PO/JO

#### **Neni 5**

### **II. UDHETIMI ZYRTAR BRENDIA VENDIT**

1. Kërkesa për udhëtim brenda vendit bëhet në përputhshmëri me këtë Rregullore dhe vetëm kur atëherë udhëtimi do të zgjasë më shumë se 24 orë. Kërkesa e tillë duhet të përmbajë: arsyetimin për udhëtim, shpenzimet eventuale lidhur me vendosjen dhe shpenzimet e tjera të udhëtimit.
2. Në rast të udhëtimit brenda vendit, shuma e mëditjeve paguhet në bazë të kësaj Rregulloreje.

#### **Neni 6**

1. Pagesa për ditët e udhëtimit fillon në ditën e nisjes dhe përfundon në ditën e kthimit.
2. Dita e nisjes dhe dita e kthimit llogariten si ditët e udhëtimit pa marrë parasysh kohën e nisjes apo të arritjes.

### **III. MËDITJET**

#### **Neni 7**

1. Mëditja për udhëtim jashtë vendit llogaritet në lartësinë e përcaktuar me Tarifat për Mëditje të udhëtimit jashtë vendit për shtetet e caktuara gjegjësisht vendet e kategorizuara sipas nenit 12 të kësaj Rregulloreje.

*Rregullore për mëditje, pagesa dhe shpërblime*

### Neni 8

2. Llogaria e dhënieve për mëditje për udhëtime jashtë vendit kryhet përmes një mëditje për çdo 24 orë të kaluar në udhëtim jashtë vendit, si dhe për kohën e mbetur më të gjatë se 12 orë. Për kohën e mbetur prej 8 deri 12 orë, llogaria bëhet përmes gjysmë mëditjes.

### Neni 9

1. Mëditjet e caktuara për shtetet e jashtme në të cilat udhëtohet, llogariten nga ora e kalimit të kufirit të Kosovës, kurse mëditjet e caktuara për shtetin e jashtëm nga i cili arrihet deri në hyrjen e kufirit të Kosovës.
2. Nëse për udhëtim shfrytëzohet aeroplani, mëditja llogaritet nga ora e nisjes së aeroplanit nga aeroporti i Kosovës e deri në kthimin e aeroplanit në aeroportin e Kosovës.
3. Për çdo ndalim, apo tej udhëtim nëpër shtet të jashtëm i cili zgjatë më tepër se 8 orë, llogaritet mëditja sipas tarifës së mëditjes për atë shtetbazuar në kategoritë e kësaj Rregullorëje.

### Neni 10

Shpenzimet për kontrollime mjekësore, viza, thirrje telefonike e nevoja të ngjashme kur ato janë të domosdoshme me miratimin e udhëheqësit të udhëtimit për kryerjen e punëve dhe detyrave të caktuara janë detyrin financiar i FKK-së, llogariten në bazë të faturave përkatëse.

### Neni 11

#### Llogaritja e mëditjeve dhe shpenzimeve tjera jashtë vendit

1. Dhëniet për udhëtim zyrtar jashtë vendit pranohen në bazë të llogaritjes së shpenzimeve të udhëtimit të cilat dorëzohen në afat prej 5 ditësh nga dita kur ka përfunduar udhëtimi.
2. Llogaritjes së shpenzimeve të udhëtimit i bashkëngjiten:
  - 2.1 urdhëresa për udhëtim dhe provat mbi shumën e paguar për shfrytëzimin e:
    - 2.1.1. biletës së udhëtimit,
    - 2.1.2 fatura e hotelit dhe shpenzimet tjera të pranuar, si p.sh., taksat në aeroport, bagazhet etj.

### Neni 12

#### IV. KATEGORIT PËRFITUESE SIPAS SHTETEVE:

1. Kategoria A (40 € përfitojnë kategoritë nga neni 2.1, i kësaj Rregullorëje)  
Kategoria A (17 € përfitojnë kategoritë nga neni 2.2, i kësaj Rregullorëje)  
Kategoria A (15 € përfitojnë kategoritë nga neni 2.3, i kësaj Rregullorëje)
2. Kategoria B (35 € përfitojnë kategoritë nga neni 2.1, i kësaj Rregullorëje)

*Rregullore për mëditje, pagesa dhe shpërblime*

Kategoria B (15 € përfitojnë kategoritë nga neni 2.2, i kësaj Rregullorëje)  
Kategoria B (12 € përfitojnë kategoritë nga neni 2.3, i kësaj Rregullorëje)

3. Kategoria C (30 € përfitojnë kategoritë nga neni 2.1, i kësaj Rregullorëje)  
Kategoria C (13 € përfitojnë kategoritë nga neni 2.2, i kësaj Rregullorëje)  
Kategoria C (10 € përfitojnë kategoritë nga neni 2.3, i kësaj Rregullorëje)

### **Neni 13**

1. Rimbursimi i mjeteve financiare për udhëtimet e realizuara nga ana e përfitueseve nga kjo Rregullore, bëhet në afatin sa më optimal nga ana e FKK-së.
2. Kategoritë e rimbursimeve të lartpërmendura janë në Shtojcën nr1 të kësaj rregulloreje.
3. Pagesat për Shpërblime është e paraqitura në Shtojcën nr 2 të kësaj rregulloreje.

## **V. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

### **Hyrja ne fuqi**

### **Neni 14**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Bordi Ekzekutiv i FKK-së dhe nga nënshkrimi i Kryetarit të FKK-së.

Prishtinë, 19 qershor 2021

Ismet Krasniqi

\_\_\_\_\_

Kryetar

**SHTOJCA 1**

*Rregullore për meditje, pagesa dhe shpërblime*

KATEGORIA A	KATEGORIA B	KATEGORIA B
Albania	Algeria	Afghanistan
Angola	American Samoa	Belize
Anguilla	Armenia	Benin
Antigua and Barbuda	Australia	Bhutan
Argentina		Burkina Faso
Aruba	Belarus	Canary Islands
Austria	Botswana	Cape Verde
Azerbaijan	Brunei	Central African Republic
Bahamas	Bulgaria	China
Bahrain	Cambodia	Cyprus
Bangladesh	Cameroon	Equatorial Guinea
Barbados	Canada	Fiji
Belgium	Chad	French Guiana
Bolivia	Comoros	Gambia
Bosnia and Herzegovina	Cook Islands	Gibraltar
Brazil	Costa Rica	Guinea Bissau
Burundi	Denmark	Indonesia
Chile	Ecuador	Iraq
Dominican Republic	El Salvador	Laos, People's Dem. Rep.
Greenland	Estonia	Lesotho
Grenada	Finland	Macao
Honduras	French Guiana	Madagascar
Hong Kong	French Polynesia	Malaysia
Italy	Gabon	Maldives
Kazakhstan	Greece	Mali
Kenya	Guadeloupe	Mauritania
Kuwait	Guam	Micronesia
Lebanon	Guatemala	Mongolia
Libyan	Guinea	Myanmar
Arab	Guyana	Namibia
Jamahiriyah	Hungary	Nauru
Malawi	Iceland	Nepal
Malta	Iran	New Caledonia
Mexico	Ireland	New Zealand
Monaco	Jamaica	Niger
Netherlands	Jordan	Niue
Antilles	Kiribati	Papua New Guinea
Nicaragua	Kyrgyzstan	Samoa
Northern Mariana Islands	Lithuania	Sao Tome & Principe
Norway	Luxembourg	Senegal
Pakistan	Macao	Slovakia
Paraguay	Madagascar	Solomon Islands
Peru	Marshall Islands	Somalia

*Rregullore për meditare, pagesa dhe shpërblime*

Puerto Rico	Martinique	South Africa
Republic of Korea	Mauritius	Sri Lanka
Republic of Moldova	Montserrat	Swaziland
Republic of Yemen	Morocco	Togo
Romania	Oman	Tokelau Islands
Russian Federation	Palau, Republic of	Tonga
Saint Kitts and Nevis	Panama	Tunisia
Saint Lucia	Papua New Guinea	Tuvalu
Saudi Arabia	Philippines	Viet Nam
Seychelles	Poland	Wallis & Futuna Islands
Sierra Leone	Portugal	West Bank and Gaza Strip
Singapore	Qatar	
Spain	Reunion	
St. Vincent Grena	Rwanda	
Sudan	Sao Tome & Principe	
Sweden	Slovenia	
Switzerland	Suriname	
Syrian Arab Republic	Thailand	
Tajikistan	Turkmenistan	
Tanzania, United Rep. of	Turks and Caicos Island	
TFYR of Macedonia	Uruguay	
Trinidad and Tobago	Vanuatu	
Uganda	Zambia	
Ukraine	Zimbabwe	
United Arab Emirates		
United Kingdom		
United States of America		
Uzbekistan		
Virgin Islands (UK)		
Virgin Islands (USA)		

## SHTOJCA NR 2 / SHPERBLIMET

Kampionati <b>BOTËROR</b>		Kampionati <b>EUROPIAN</b>	
Seniorët	Kadetët / juniorët/U21	Seniorët	Kadetët / juniorët / U21
I 5 000 euro	1500 euro	3 500 euro	1200 euro
II 3 000 euro	1000 euro	2 200 euro	800 euro
III 2 000 euro	800 euro	1 500 euro	500 euro
1 pikë = 1 €			

*Rregullore për meditje, pagesa dhe shpërblime*